REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 860/20
Datë/Datum. 26.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për aktivitetin e prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr[1] i prokurimit** | **611-20-4770-5-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **611-20-077-521** |

Sa i përket tenderit për: **NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TËZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeqarë.**

## ANKESË

**1.Identifikimi i ankuesit***

**Grupi i OE "Globi" Trans NN & "Trasing Group" SH.P.K.**
***(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)***

**Pavlan**
***(Adresa)***

***Pejë*** ***30000***
***(Vendi)*** ***(Kodi postar)***

**049/613 111**
***(Numri Telefonit)*** ***(Numri i Faks-it)***

**Jeton Daci**
***(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)***

**Globitrans1@gmail.com**
***(Adresa elektronike)***

***26.10.2020***

***(Data e parashtrimit të ankesës)*** ***(Nënshkrim dhe vula)***

N.N. Globi Trans 810420141

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Njoftimi për Kontratë: 27.08.2020<br>Data e hapjes së ofertave: 23.09.2020<br>Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm: 13.10.2020<br>Kërkesa për rishqyrtim dt. 16.10.2020<br>Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 16.10.2020 |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**
**Neni 6 i LPP-së**
**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 56 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 60 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar ne me dt. 13.10.2020 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë "GR.OE N.N.T MILAZIM SHALA & BUJAR SHABANI B.I & V-SHALA SH.P.K" ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar, me arsyetimin se: *"Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale-nga lista e pajisjeve ju mundojnë dy minidampera (keni prezantuar damper) si dhe dokumentacion për të njëjtin; mungon edhe vendimi i gjeodetit; menaxheri i projektit inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndërtimatrisë)" Arsyeja B dhe C nuk janë arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A".*

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë të pa bazuar për arsyet si në vijim:

Arsyeja e parë e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 kërkesë ka qenë *"Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Tre eskavator gërmues dhe ngarkues min 18 t.; Pesë kamion transporti të materialit të kapacitetit min 10 ton; , Dy Mini Damper ,Një Bulduzher ,marveshjen per furnizim me zhavore ,Marveshje per furnizim gypa te betonit ,Nje makin hidraulike per shpim ,Nje pomp per largimin e ujrave nga kanali ,Makine per ngjeshjen e kanalit"*, ndërsa si dëshmi është kërkuar *"Lista e paisjeve - te skanuara nga origjinali për të gjitha kërkesat rreth paisjeve d te jene te skanuara nga origjinali ) që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre (qera), duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i - njeren prej tyre duhet marreveshjet per furnizimet e kerkuara -te skanuara nga origjinali"*.
Pra në kërkesën e lartcekur shihet qartë se AK-ja nuk e ka përcaktuar fare tonazhën e damperit, andaj ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk është e përcaktuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Nëse AK-ja do ta kishte cekur tonazhën ne do ta ofronim pajisjen sipas kërkesës së AK-së, ashtu siç kemi vepruar edhe tani sipas kërkesës së AK-së.

Vlen të theksohet se në njërën nga kontratat tona të nënshkruara me AK përkatësisht kontrata për aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Polek i Vjetër, Polek i Ri dhe Vasilevë; Zabel i Ulët, Zabel i Epërm dhe Korroticë e Epërme dhe Korretic e Ulët; Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët-Projekt dy vjeçar", me nr. të prokurimit: 611-20-4539-5-2-1, ku për këtë aktivitet ne kemi nënshkruar kontratë edhe pse kërkesa në lidhje me damperin ka qenë e njëjta dhe ne kemi ofertuar me të njëjtën pajisje, mirëpo në projektin e lartcekur ne kemi nënshkruar kontratë, ndërsa tani në këtë aktivitet të prokurimit jemi eliminuar edhe pse i kemi prezantuar pajisjet e njëjta sikurse ne aktivitetin e lartcekur.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne po diskriminohemi nga ana e AK-së, pasi që po eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit për kërkesa të cilat nuk janë të parashikuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Arsyeja e AK-së e lartcekur për eliminimin tonë është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP ku shkruan qartë se *"56.3 Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*
Pra ne jemi eliminuar për një arsye dhe kërkesë e cila nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit, prandaj veprimi i AK-së bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Gjithashtu AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar si arsye tjetër e ka cekur se ju mungon edhe vendimi i gjeodetit, mirëpo ne jemi të habitur se si mund të vendosni një arsye të tillë për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, pasi që askund në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë nuk është parashikuar një kërkesë e tillë, andaj duke u bazuar në këtë fakt shihet qartë se ne po diskriminohemi haptas nga ana e AK-së, pasi që po eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit për kërkesa të cilat nuk janë të parashikuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, pra edhe kjo arsye e AK-së nuk qëndron dhe është e pa bazuar.

Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit ku AK-ja e ka cekur se tek *menaxheri i projektit*

*inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndërtimatrisë),* kjo arsye e AK-së për eliminimin tonë është e pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se në kohën e diplomimit të inxhinierit të prezantuar nga ana jonë nuk kanë ekzistuar drejtimet e caktuara, mirëpo dega e ndërtimtarisë e ka përfshirë edhe drejtimi Hidro. Pra nëse shikohet diploma e inxhinierit të prezantuara nga ana jonë shihet qartë viti i diplomimit pra viti 1978, pra periudha e diplomimit të inxhinierit të prezantuar nga ana jonë ka qenë në kohën e Republikës Socialiste Federative Jogusllave, andaj siç e cekëm më lartë në këtë kohë nuk kanë ekzistuar drejtimet e caktuara mirëpo në degën e ndërtimtarisë kanë qenë të përfshira edhe drejtimet tjera, ndër të tjera edhe drejtimi Hidro, siç e ka kërkuar AK-ja në FDT.
Andaj nga faktet e lartpërmendura shihet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është e pa bazuar.

Sa i përket letrës standarde për tenderues të eliminuar nga ana e AK-së ju sqarojmë se është shumë kundërthënëse, pasi që në fillim AK-ja i ka cekur tri arsye për eliminimin tonë ndërsa në fund e ka shënuar se kërkesa B dhe C nuk janë arsye për eliminim, andaj këtu shihet shumë qartë jo serioziteti i AK-së për vlerësimin e ofertave.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit pasi që edhe pse i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë, mirëpo jemi eliminuar për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë dhe gjithashtu jemi më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë në vlerë prej **19,644.50€.**

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e grupit të **OE IBRAHIM KURRUMELI B.I. & VALDRINI SH.P.K & ASFALT GROUP SH.P.K.**, pasi që ky grup i OE është i papërgjegjshëm.

Ne me dt. 16.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
Në lidhje me arsyen e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur se AK-ja ka vlerësuar që punimet në teren nuk mund të kryhen me llojin e makinerisë për shkak të terrenit të ngushtë.
Mirëpo ne ju sqarojmë se kjo arsye e AK-së është absurde dhe e pa bazuar pasi që ne po eliminohemi për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, pasi që askund nuk është cekur tonazha e damperit. Ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk është e përcaktuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Ne e kemi cekur shumë qartë se nëse AK-ja do ta kishte cekur tonazhën ne do ta ofronim pajisjen sipas kërkesës së AK-së, ashtu siç kemi vepruar edhe tani sipas kërkesës së AK-së, andaj ne nuk duhet të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit për fajin e autoritetit kontraktues, pasi ne po diskriminohemi duke u eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit, prandaj veprimi i AK-së bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Ndërsa në lidhje me arsyetimin e AK-së se për vendimin e gjeodetit dhe për menaxher nuk janë kërkuar sqarime shtesë, për arsye se nuk janë ofruar dëshmitë për damper, mirëpo ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është absurd sepse nëse ne nuk do ti plotësonim kërkesat në lidhje me menaxherin dhe gjeodetin, AK-ja do ti cekte arsyet se përse nuk i plotësojmë këto kërkesa, mirëpo e ka cekur shumë qartë se kërkesat në lidhje me menaxherin dhe gjeodetin nuk janë arsye për eliminim, edhe pse ne i kemi sqaruar shumë qartë se i plotësojmë kërkesat e lartcekura.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete për papërgjegjshmërinë tonë, pra ne jemi OE i përgjegjshëm sepse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet qartë se qëllimi i AK-së është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Prandaj me këtë veprim të AK-së po rrezikohet të dëmtohet buxheti në vlerë prej 19,644.50€ pa ndonjë arsye konkrete.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

**VENDIM**

**APROVOHET,** si e bazuar ankesa e OE **Grupi i OE "Globi" Trans NN & "Trasing Group" SH.P.K.**
**ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*